

Përgatitën:

Hilmnijeta Apuk në bashkëpunim me Fazile Bungu

Bonton

në komunikim me personat me aftësi të kufizuara

Dinjiteti Juaj = Dinjiteti Im



donator:



"This project was funded through a U.S. Office Pristina grant. The opinions, findings, and conclusions or recommendations expressed herein are those of the Author(s) and do not necessarily reflect those of the Department of State."

Botim i parë & Botim i parë akustik për të verbër dhe me pamje të zvogluar

Little People of Kosovo

www.lpkosova.com

PROMOTIONAL VOLUNTARY PROGRAM

NGOs PARTNERSHIP OF KOSOVA
Prishtinë , Prill 2007.

SH.P.A.K

HENDIFER

E dizajnuar nga: Hilmnijeta Apuk , e-mail: info@lpkosova.com

Parathënje

Secili person me aftësi të kufizuara ka të drejtë në respektimin e integritetit fizik e mental në bazë të barazisë me të tjerët.

Cili është personi me aftësi të kufizuara?

Në aftësi të kufizuara llogariten gjendjet fizike, mentale dhe senzore siç janë, verbëria, të shurdhërit, lëvizja e vështërsuar, të metat në zhvillim dhe ato intelektuale. Disa njerëz vuajnë më shumë nga një lloj kufizimi, ndërsa të tjerë apo një shumicë e madhe në një fazë të jetës së tyre vuajnë nga ndonjë gjendje si pasojë e lëndimit fizik, sëmundja apo mplakja.

Shpesh herë personat me aftësi të kufizuara i ekspozohen shkeljes së dinjitetit të lindur njerëzor. Të përkujtojmë se 650 milion persona në botë janë përkohësisht apo gjatë tërë jetës me kufizime psikofizike, andaj lind nevoja për të kërkuar mundësi dhe pjesmarje efektive në shoqëri në bazë të jodiskriminimit dhe barazisë me të tjerët.

Duhet pranuar se jeta e personave me aftësi të kufizuara në mbarë botën vetvetiu nuk është aspak e lehtë dhe jo rrallëherë bëhemi viktimë të dhunës, eksploatimit e keqtrajtimit në familje e sidomos në shoqëri duke na u kufizuar liria e lëvizjes, ndonjëher edhe për shkak të paragjykimëve patriarkale dhe barrierave që na rrethojnë anë e kënd vendit.

Njoftimi jo i duhur për nevojat dhe mundësit e personave me aftësi të kufizuara, mosnjohja e mënyrave të dhënjes së ndihmës apo frika nga takimi me të panjohurën, i bënë njerëzit të ngathtë që lirshëm të komunikojnë dhe ofrojnë ndihmë.

Me dëshirën e madhe që tua lehtësojmë përditshmërin njerëzve me aftësi të kufizuara dhe ti nxisim njerëzit që të kontaktojnë pa frikë dhe paragjykime stereotipe, bëme përpjekje ta botojmë këtë bonton duke Ju lutur ta lexoni me dashuri.

Me respekt,

Hiljmnijeta Apuk, eksperte për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara dhe përfaqesuese e OJQ-së Little People of Kosova në Ad Hoc Komitetin -e KB në përpunimin e vrsionit punues të tekstit të Konventës mbi të drejtat e kësaj kategorie të qytetarëve.


Bashkpuntorë, Fazile Bungu,



Hiljmnijeta Apuk



Fazile Bungu



Në takim me personat me aftësi të kufizuara:



- Ti drejtoheni dikujt me nofkë për shkak të paaftësisë së tij fizike është një sjellje tejet ofenduese, ngase personat me aftësi të kufizuara kanë emrin e tyre. Prandaj, thirni direkt me emër. Kjo do ti bën më të lumtur. Bëjani të ditur këtë fakt të tjerëve. Mos na etiketoni, vetëm se keni patur më shumë fat në jetë.
- Pyeteni gjithmonë personin me aftësi të kufizuara cila është mënyra më e mirë për ta ndihmuar. Mos u ndieni të lënduar nëse ndihma juaj refuzohet, sepse ndoshta në atë çast vetëm do ta pengonte në funksionimin e tij. Ndihma juaj do të jetë e mirëseardhur çdo herë e në çdo çast tjetër.
- Mos u drejtoni me nguti e as pas shpine personave, lëvizja e të cilëve është e vështërsuar, sepse mund ti friksoni dhe ata lehtë mund ta humbin drejtpeshimin.
- Mos supozoni e as paragjykoni se një person ka apo nuk ka të meta fizike, ngase shumë njerëz mund të kenë kufizime të natyrave të ndryshme por që nuk mund të shihen me sy.
- Mos bëni komente të kësaj natyre, si: "Unë nuk kisha mund të jetoj po të isha kështu ...!"



- Nëse një person ka nevojë për ndihmë gjatë lëvizjes, natyrisht se ajo/ai ka nevojë të mbështetet për ju. Kur mos e kapni dike për dore me qëllim që ta udhëhiqni, nëse paraprakisht nuk e keni pyetur. Bëni përpjekje që lëvizja e juaj të jetë në harmoni me atë që i ofroni ndihmë.
- Mos i kapni dorëzat e karrocës dhe mos filloni ti shtyni, nëse paraprakisht nuk keni marrë pëlqimin nga personi, mos u prekni poqese ndihma juaj refuzohet.
- Mos u mbështetni në karrocë dhe mos i bieni asaj - sepse mund ta prekni dhe pengoni personin brenda hapsirës së tij .
- Poqese ju duhet që ta bartni karrocën nëpër shkallë, pyeteni personin në karrocë, se cila do të ishte mënyra më e mirë për ta ndihmuar në këtë rastë.
- Mos e lejoni fëmiun tuaj që zëshëm dhe me përbuzje të komentojë dobësit fizike të dikujt që gjendet në rrethin tuaj. Premtoni se në shtëpi do tia shpjegoni realitetin e jetës.
- Bisedoni me fëmiun tuaj mbi tolerancën ndaj atyre që në çfardo mënyre janë të ndryshëm.



- Pengoni fëmijët tjerë që të mos shtrembërohen, në dallimet e kaluesve të rastit me të meta fizike.
- E rëndësishme është që ta ndihmoni fëmijun tuaj në të kuptuarit e vështërsive dhe problemeve me të cilat ballafaqohen personat me aftësi të kufizuara.
- Respektoni jetën private dhe dinjitetin njerëzor të bashkëshortëve me çrast njëri apo tjetri ose që të dy mund të jenë me kufizime, mos komentoni zëshëm dhe mos paragjykoni dashurin e jetën e tyre të përbashkët. Konsideroni dhe respektoni si të barabartë me të tjerët.
- Përshëndetuni ahtu siç i përgjigjet më së miri personit me aftësi të kufizuara.
- Drejtohuni direktë personit me aftësi të kufizuara, e kursesi prindit apo përcjellësit të tij.
- Gjatë bisedës me personin shtatë shkurtër ose personin në karocë bëni përpjekje që të uleni në mënyrë që të keni mundësi të bisedoni sy më sy.
- Me kujdes të veçantë dëgjone personin i cili ka ndonjë të metë në të folur. Nëse nuk e keni kuptuar luteni që ta përsëris. Mos argëtoni se e keni kuptuar, kjo mund ta ofendoj më shumë.



Flisni ngadal dhe direkt me personin që ka probleme me të dëgjuarit. Mos bërtitni, mos i folni në vesh. Lëvizjet e gojës dhe gjestet tuaja do t'ndihmojnë që më lehtë tu kuptoj. Nëse nuk jeni të sigurt se jeni kuptuar - shkruani një mesazh.

Personit shurdhmemec apo personit me pengesa në të dëgjuar shkruani informatat që keni dëgjuar përmes autoparlantit lidhur me fluturimin e aeroplanit, nisjes së autobusit, trenit, anijes ...

Duke përshëndetur personin e verbër apo ate me shikim të dobësuar, thuani shkurt kush jeni .Nëse ofroni ndihmë për të ecur, ofroni mundësin që të mbështetet në krahun tuaj.

Shurdhmemecët e që njëkohësisht janë të verbër mund tu kuptojnë vetëm me prekje. Nëse gjendeni në situatë që të komunikoni me ta, vendosni kontakt duke spjeguar me gishtat e tij.

Mos e pyetni personin me aftësi të kufizuara për shkaqet e gjendjes së tij, poqese nuk jeni i afërt me te.

Mos u shtrembëroni, mos përsëritni zëshëm apo mos tregoni haptazi gjestet të cilat direkt kishin për ta shqetësuar personin me të meta mentale apo psikosociale.

Poqese në vendin e punës keni ndonjë kolegë me aftësi të kufizuara respektoni mundësit e tij profesionale.

Bëhuni të duruar dhe të kujdesshëm, sepse personave me aftësi të kufizuara ju duhet më shumë kohë për ta kryer ndonjë punë, fokusohuni në ate se çka mund të bëjnë ata.



Mos e lavdëroni tejet mase personin me aftësi të kufizuara për kryerjen e ndonjë pune normale jetësore.

Duke pritur në rradhë ipni përparësi dhe hapni rrugë që personi me lëvizje të vështërsuar të mund të afrohet.

Në trafikun urban ndihmoni, personin me aftësi të kufizuara të ulet dhe sa më lehtë të mund të hyj e të zbres si në autobus, tramvaj, aeroplan, anije

...


Mjetet ndihmëse si (kukëzat, karroca) merrni në dorrë, vetëm atëherë kur ju lut personi me aftësi të kufizuara.

Mos e përgëdhelni qenin i cili udhëheq personin e verbër, fillimisht kërkoni leje nga pronari.

Respektoni vozitësit me aftësi të kufizuara. Kur në trafik hasni makinë me shenjë, "invalidi" ruani distancën, zvogloni shpejtësin, bëhuni më të kujdesshëm. Keni konsiderat ndaj lëvizjeve të ngathta të tyre. Mos u parkoni në vendet e shënuara e të rezervuara për "invalid".

Mos tregoni dhemshuri ndaj personave me aftësi të kufizuara, silluni si ndaj të barabartëve me ju dhe të tjerët.





GRATË ME AFTËSI TË KUFIZUARA

"A do të hidheshit në zjarr për te?" apo " Bëhuni princesh dhe gjejeni princin tuaj", gratë pa këmbë, pa duar, të verbëra, shurdhmemece ... gratë me aftësi të kufizuara kanë të drejtë në dashuri njësoj si të tjerat. Mos u ndieni të palumtura vetëm pse **AI** nuk është lajmëruar ose nuk keni takuar mashkullin e jetës suaj, ata janë diku rreth jush, prandaj përpiquni që ti vendosni në perspektivën tuaj, do të shihni sa të shumtë janë, ndryshoni qëndrimin mbi veten si grua me më pak vlera dhe pak e rëndësishme. Jo, **Ju** nuk jeni e parëndësishme, secila grua posedon vlera, të cilat çdo mashkull me kënaqësi do ti zbulonte, natyrisht nëse këte ua lejoni. Bëne këtë hap pa frigën nga zhgënjimi apo disfata, sepse çdo lidhje mes dy personave, bartë me vete një rrezik të tillë. Jeta na ka dëshmuar se edhe bukuroshet e botës jo rrallherë braktisen nga të dashurit e tyre, edhe ato vuajnë dhe ndjehen të lënduara edhe pse nuk kanë pengesa psikofizike. Çdo grua me aftësi të kufizuara për një çast është fat i dikujt, këte duhet provuar dhe si rast nuk duhet lëshuar. Shijoni bukurin e jetës, çastin për të dashuruar dhe për të qenë e dëshiruar, ndonjëherë ja vlen për të jetuar edhe vetëm për një çast lumturie në jetë. Ate askush nuk ta fal, lumturin duhet merituar, prandaj shikoni rreth vetes dhe lumturin tuaj ndane me dikë tjetër, kjo është vlerë njerëzore, me pak përpjekje nga të gjithë mund ta shndrojmë në **Vlerë Universale**.

Përpiquni të bëni më shumë, eliminoni diskriminimin ndaj personave me aftësi të kufizuara ndaj të gjitha çështjeve lidhur me mardhënjet martesore, familjare, personale e prindore. Kontribuoni në barazimin e mundësive të personave me aftësi të kufizuara në bazë të barazis me të tjerët.

**Ndonjehere ndodh qe njerezit se
pari ti verejne te metat tona,
e me pas te na shohin ne si persona,
kjo eshte per ne nje
situatë tejet e rende.**

